



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 5 shkronja c) 11, 12.2 shkronja d), 17 shkronja f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 19 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2023, mori këtë:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE – “EKO-LLAPI” SH.A.

Neni 1

1. Ngritet Komisioni Komunal i Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale - “Eko-llapi” Sh.A. Podujevë, në përbërje si vijon:

- z. Bahri Blakçori**, i emëruar nga Kuvendi i Komunës
- z. Burim Hasani**, i emëruar nga Kuvendi i Komunës

2. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë emëron një anëtar/e në kuadër të këtij Komisioni.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtareve të Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, me plotësim ndryshimet e bëra me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, Ligjit nr.02/L-016 për Shoqëritë Tregtare, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0079532/23
Podujevë, datë: 31-10-2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronjat e) f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, neneve 16, 19 paragrafët 1.5; 1.6 dhe nenit 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 të Vendimit nr.prot.01-016/01-0079532/23 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi”, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 31 tetor 2023, merr,

VENDIM PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE “EKO-LLAPI” SH.A. NË PODUJEVË

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë, emërohet,

z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-016/01-0079532/23 të datës 31 tetor 2023.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
Arkives*

Nr.Prot. 02-020/04-0083474/23
Podujevë, datë: 22.11.2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi